



PROGEEN
CONSTRUCTION

PROFILI I KOMPANISË

DHJETOR 2025

RRETH SHOQËRISË

NDËRTOJMË PËR TË PËRMIRËSUAR

Progeen shpk është një shoqëri ndërtimi e cila ushtron aktivitetin e saj në Shqipëri që prej vitit 2013 në rolin e investitorit dhe ndërtuesit.

Shoqëria është e specializuar në ndërtime rezidenciale, industriale, vepra publike dhe infrastrukture.

Progeen ka përfunduar me sukses 158,053 m² projekte ndërtimi. Ndër to projekte si Rezidenca Progeen 1, Progeen 2, Rezidenca Rainbow dhe Rezidenca IRIS, ku shoqëria ka qenë në rolin e investitorit.

Gjithashtu shoqëria ka ndërtuar projekte me çelësa në dorë për organizata vendase dhe ndërkombëtare si UNDP, Eagle Hills Enterprise Properties, Shoqata FARA, All For Freedom, ALEAT, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Tiranë etj.

Momentalisht, Progeen shpk është duke kryer projekte ndërtimi me sipërfaqe të përgjithshme 196,363 m² nga të cilat 31,012 m² në rolin e kontraktorit dhe 165,351 m² në rolin e investitorit.

Ne angazhohemi për cilësinë, sigurinë dhe inovacionin në çdo projekt duke ndërtuar për një të ardhme më të mirë për të gjithë.



 **158,053 m²**

Projekte të përfunduara nga shoqëria në rolin e investitorit dhe ndërtuesit.

 **165,351 m²**

Projekte në proces në rolin e investitorit

 **31,012 m²**

Projekte në proces në rolin e kontraktorit

 **> 275**

Punonjës të përhershëm të kualifikuar të specialiteteve të ndryshme



STAFI

Suksesi i shoqërisë i atribuohet një ekipi shumë të aftë profesionistësh të cilët çojnë përpara çdo projekt. Progeen shpk ka në organikën e saj një staf teknik të përbërë nga inxhinierë e arkitektë të specialiteteve të ndryshme, të cilët ndër të tjera, mbështesin edhe operacionet e përditshme të shoqërisë në kantiere. Gjithashtu stafi i Progeen shpk ka specialistë me përvojë të fushave të tjera si financë, administrim, shitje, marketing, jurisprudencë etj.

Shoqëria e mbështet stafin e saj profesionalisht, inkurajon inovacion dhe kultivon vlera njerëzore dhe profesionale në çdo hallkë të organikës së saj.

STAFI TEKNIK I PROGEEN PËRBËHET NGA:

- 10+ arkitektë
- 46+ inxhinierë (të fushave të ndryshme)
- 20+ specialistë të tjerë



VIZIONI & VLERAT

Që në zanafillën e saj, shoqëria Progeen ka pasur një rrugëtim të suksesshëm në fushën e ndërtimit. Duke synuar progresin e vazhdueshëm dhe pa bërë kompromis në cilësi, kemi ndërtuar një reputacion të besueshëm në tregun e ndërtimit.

Për ne, integriteti është në qendër të çdo marrëdhënieje. Që në fillimet tona, jemi angazhuar të tejkalojmë pritshmëritë e klientëve tanë duke ofruar shërbime ndërtimi me një standard të lartë profesionalizmi.

Ndryshimet teknologjike dhe kërkesat e ndryshme të industrisë na kanë nxitur të evoluojmë dhe të përshtatemi, duke ruajtur gjithmonë fokusin drejt cilësisë por duke përqafuar edhe inovacionin në çdo projekt.

Për të ardhmen, jemi të angazhuar të vazhdojmë këtë rrugëtim duke u përqendruar në zgjerimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e teknologjisë për ofrimin e zgjidhjeve gjithnjë e më të mira.

Progeen shpk synon të jetë një lider në industrinë e ndërtimit në Shqipëri dhe rajon duke ndërtuar projekte shumë cilësore dhe gjithnjë e më ambicioze.






NDËRTIM ME CELËSA NË DORË

- **Progeen shpk** ofron shërbimin e ndërtimit me çelësa në dorë për projekte të ndryshme, nga ato rezidenciale, deri tek industrialet dhe infrastruktuoret.

Shoqëria përfshin të gjitha proceset e ndërtimit nga projekti arkitekturor, projekti i zbatimit, analiza e kostove, parashikimet financiare, planifikimi, menaxhimi i dokumentacionit teknik për lejet e nevojshme deri tek veprimtaritë e përditshme të ndërtimit.



PROJEKTIM & PLANIFIKIM

Si pjesë e pandarë e ndërtimit me çelësa në dorë, faza e projektimit dhe planifikimit përfshin të gjitha veprimtaritë e nevojshme përpara se të fillojë ndërtimi i një projekti.

Kjo fazë, e zhvilluar në bashkëpunim të vazhdueshëm me klientin, mundëson përcaktimin e prioriteteve të projektit, identifikimin e problematikave potenciale, planifikimin dhe detajimin e grafikëve të punimeve, prokurimin dhe koordinimin paraprak të aktiviteteve që pasojnë.

Faza e Projektim-Planifikimit është shumë e rëndësishme për ecurinë e projektit të ndërtimit në mënyrë që të sigurohet fizibiliteti, cilësia, siguria dhe të evitohen tejkalimet e mundshme të buxheteve.

Proceset që përfshihen në këtë fazë janë:

- Analiza e trullit të ndërtimit dhe rilevimi topografik
- Zhvillimi i projektit
- Vlerësimi i kostove dhe teknologjive të ndërtimit
- Prokurimi i materialeve dhe makinerive
- Menaxhimi i dokumentacionit për lejet ndërtimore të nevojshme
- Buxhetimi dhe skedulimi

Këto procese mundësojnë :

- Planifikim të qartë dhe të detajuar të projektit
- Parashikim të saktë dhe realist të kostove
- Krijimin e një grafiku punimesh realist
- Identifikimin e të gjitha kapaciteteve të nevojshme për projektin
- Ndërtim të mirë-koordinuar





NDËRTIM CIVIL DHE REZIDENCIAL

Progeen shpk ofron një gamë të plotë të shërbimeve të ndërtimit për tipologji të ndryshme projektesh, nga ndërtesat rezidenciale dhe komerciale deri te objektet industriale dhe infrastrukturore. Shoqëria ka ekspertizën dhe burimet e nevojshme për të ofruar zgjidhje cilësore dhe efikase.

Shoqëria është e specializuar në projekte me çelësa në dorë, ku ndjek çdo aspekt të projektit nga projektimi deri te dorëzimi, duke siguruar cilësi dhe efikasitet.

Progeen shpk ka përfunduar me sukses projekte për klientë vendas dhe ndërkombëtar. Projektet e mëparshme dhe ato aktuale tregojnë për arritjet e shoqërisë si edhe për dedikimin e saj ndaj inovacionit dhe ekselencës.



INVESTO ME PROGEEN

Progeen shpk mundëson mundësi investimi në nëpër projektet e saj të reja apo forma të tjera bashkëpunimi. Opsionet e ndryshme për investim janë si më poshtë:

- ▶ Rezervimi i hershëm në projektet e ardhshme: Ky opsion ju mundëson të rezervoni një pronë përpara se të fillojë ndërtimi apo ne fazat e hershme të planifikimit. Ju mund të zgjidhni pronat ndër projektet në zonat më të kërkuara dhe ti personalizoni ato sipas nevojave specifike tuajat apo destinacionit të biznesit tuaj që në fazat e hershme të projektimit. Nëpërmjet rezervimit të hershëm ju mund të siguron shtëpinë ose zyrën tuaj të ardhshme duke përfituar nga rritja e vlerës së pronës në kohë.
- ▶ Zhvillimi i truallit/trojeve: Ju mund të jepni tokën tuaj për zhvillim kundrejt përqindjes mbi sipërfaqen totale të ndërtimit. Në këtë mënyrë mund të ktheni një aset të fjetur ose një pronë të pa-përdorur në një vlerë të konsiderueshme për ju.
- ▶ Progeen gjithashtu është e hapur për forma të tjera bashkëpunimi me palë serioze në formë partneriteti ose bashkëinvestimi, për projekte specifike etj. Nëse keni një propozim konkret doni ta zhvilloni më tej, ju mund të kontaktoni me kompaninë për të diskutuar apo për t'u informuar më shumë lidhur me mundësitë e bashkëpunimit. Shoqëria do të vlerësojë me kujdes propozimin tuaj, dhe do t'ju ofrojë zgjidhjen më të mirë të mundshme në rast se propozimi është në interes të të gjitha palëve.

Nëse jeni të interesuar të investoni me **Progeen shpk** ose doni të informoheni më shumë rreth shoqërisë dhe projekteve të saj, ju lutemi të vizitoni faqen e internetit të shoqërisë ose të kontaktoni përfaqësuesit e saj.

Investimi me **Progeen shpk** është zgjedhja e duhur për të kthyer investimin dhe impenjimin tuaj në vlerë.





PROJEKTE TË RËNDËSISHME

2013

- 1 **Themelohet Progeen shpk** – Fillon puna për Magazinë Industriale në Tiranë (Projekti i parë i shoqërisë si Ndërtues)

2014

- 2 **Fillojnë punimet për Rezidencën Progeen 1** (Projekti i parë i shoqërisë si Investitor)

2015

- 3 **Progeen 2** (Investitor & Ndërtues)

2016

- 4 **ADISA Krujë** (Ndërtues)

2017

- 5 **11 Godina shërbimi në ASHRAF 3, Manëz për shoqatën FARA** (Ndërtues)

2018

- 6 • **Rezidencës Rainbow** (Investitor & Ndërtues)
- **IRIS I** (Investitor & Ndërtues)

2019

- 7 • **Monumentet dhe Hoteli në ASHRAF 3** (Ndërtues)
- **Dega e re OTP BANK** (Ndërtues)

2021

- 8 • **Godina banimi në kuadër të rindërtimit në Lezhë** (Ndërtues)
- **Rindërtimi i Shkollës "Sherif Dervishi" Budull** (Ndërtues)
- **Godinë Parkimi Gjirokastër** (Ndërtues)
- **5 Godina banimi në kuadër të rindërtimit Valias** (Ndërtues)
- **Kompleksi Rezidencial Tërana Uptown** (në Rrugën 5 Maji) (Investitor & Ndërtues)
- **Rezidenca IRIS 2021–2023** (Investitor & Ndërtues)
- **Xhamia Persiane në Ashraf 3** (Ndërtues)

2022

- 9 • **Lotet 1D dhe 2C – Zona e Rindërtimit Spitalë** (Ndërtues)
- **Univers City, 8 godina 7–9 katëshe** (Investitor & Ndërtues)
- **Godinë Banimi Komuna e Parisit** (Ndërtues)
- **Godina 6, Seksioni A, Zona Zhvillimore Kombinat** (Projektues dhe Ndërtues)

2023

- 6 • **Parkim Publik Durrës** (Ndërtues)
- **Durrës Yacht & Marina** (Ndërtues)



KOMPLEKS REZIDENCIAL 3,4,5,6 DHE 7 KATE BANIM DHE NJË KAT PARKIM NËNTOKË

Vendndodhja: Sauk, Tiranë | Shqipëri

Sipërfaqja e ndërtimit: 16,074 m²

Klienti: Progeen shpk (investim i shoqërisë)

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim, me çelësa në dorë

Një kompleks rezidencial modern dhe elitare po ngrihet në një nga zonat më të preferuara dhe më të qeta të Tiranës – shumë pranë Parkut të Liqenit Artificial. Kjo zonë ofron një ndërthurje të përkryer mes natyrës, ajrit të pastër dhe aksesit të lehtë në qendër të qytetit.

Kompleksi rezidencial përbëhet nga godina me 3, 4, 5, 6 dhe 7 kate, të projektuara me arkitekturë bashkëkohore dhe standarde të larta ndërtimi. Çdo ndërtesë do të ketë në përdorim një kat parkimi nëntokësor, duke garantuar komoditet maksimal për banorët.

Rezidenca do të jetë një komunitet i mbyllur, me hyrje të kontrolluar përmes një porte sigurie, që ofron qetësi, siguri dhe privatësi për të gjithë banorët. Mes gjelbërimit dhe hapësirave të gjera të gjelbra të mirëmbajtura, ambienti i jashtëm i kompleksit është projektuar për të ofruar rehati dhe relaks në çdo moment të ditës.

Sipërfaqja ndërtimi

16,074 m²

Tipi i Kontratës

**Investim
Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



Kohëzgjatja e kontratës

2025 – 2030

Sipërfaqe ndërtimi

121,043 m²

Tipi i Kontratës

**Investim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**

TIRANA NEW BOULEVARD

Vendndodhja: Bulevardi i Ri, Tiranë / Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2025 – 2030

Klienti: Progeen shpk (Investim i shoqërisë)

Sipërfaqe e ndërtimit: 121,043 m²

Detyra: Ndërtimi me çelësa në dorë i dy kullave 4 & 41-kate me 6 kate parkim nëntokësor, ambiente tregtare dhe zyra

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim me çelësa në dorë

Progeen shpk, prezanton një projekt të ri ambicioz: dy kulla ikonike prej 44 dhe 41 kate, të pozicionuara në zemër të Bulevardit të Ri të Tiranës – një zonë që shumë shpejt po transformohet në destinacionin më të kërkuar dhe më të zhvilluar të qytetit.

Në krah të parkut qendror, hapësira më e madhe e gjelbër e Bulevardit të Ri, projekti ofron një kombinim unik të natyrës dhe jetesës urbane. Projektuar nga studioja e famshme Marco Casamonti & Partners, kullat dallohen për arkitekturën e tyre të veçantë, ngjyrat vivide që sjellin gjallëri dhe ballkonet e shumta që krijojnë një pamje dinamike e moderne.

Këto kulla do të ofrojnë apartamente rezidenciale, ambiente tregtare dhe zyra biznesi, duke ofruar hapësira tej mase funksionale dhe të projektuara për të përmbushur nevojat e rezidentëve dhe bizneseve moderne. Duke përdorur teknologjitë më moderne të ndërtimit të veprave të tilla dhe një lokacion strategjik, kullat tona po tërheqin interes të gjerë nga investitorë, banorë dhe profesionistë, duke shënuar një tjetër hap drejt zhvillimit urban të Tiranës dhe vendosjes së standardeve të reja.



ZBATIMI I PUNIMEVE PËR NDËRTIMIN E GODINËS SË BANIMIT NË DURRËS YACHT & MARINA

Vendndodhja: Durrës | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2023 – 2026

Sipërfaqja e ndërtimit: 26,752 m²

Klienti: Durrës Marina sh.a.

Tipi i kontratës: Ndërtim

Durrës Yachts & Marina është ndër destinacionet më të gjalla në lumin Adriatik, me pamje nga bregu i detit dhe ofron mikpritje, pazar luksoz, ngrënie, dhe përvoja argëtuese.

E vendosur pranë ujërave të kaltra të detit dhe e kufizuar nga një park qendror gjallërues dhe bulevard plot jetë, kjo hapësirë e mrekullueshme jetese ripërcakton jetën moderne.

Progeen po ndërton një prej godinave buzë detit në këtë kompleks.

Kohëzgjatja e kontratës

2023 – 2026

Sipërfaqja ndërtimi

26,752 m²

Tipi i Kontratës

**Investim
Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



Kohëzgjatja e kontratës

2022 – 2026

Sipërfaqe ndërtimi

125,611 m²

Tipi i Kontratës

**Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**

UNIVERS CITY – NDËRTIMI I 8 GODINAVE BANIMI 7 DHE 9 KATËSHE

Vendndodhja: Autostrada Tiranë – Durrës, Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2022 – 2026

Sipërfaqe e ndërtimit: 125,611 m²

Klienti: Progeen shpk (investim i shoqërisë)

Detyra: Ndërtimi i 8 godinave banimi 7 dhe 9 katëshe dhe 1 kat parkim nëntokësor

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim, me çelësa në dorë

Univers City ndodhet në zonën e Laknasit, vetëm 2 minuta nga QTU, shumë pranë autostradës Tiranë – Durrës. Vetëm 7.3 km dhe 15 minuta larg sheshit Skënderbej, ky kompleks banimi ofron mundësi aksesit në metropol dhe gjithashtu mundësinë e një jetese të qetë larg ngarkesës së kryeqytetit.

Univers City është konceptuar si një qytet universal i kompletuar me të gjitha facilitetet e nevojshme për të përmbushur të gjitha nevojat dhe komoditetet e çdo familjeje.

Progeen shpk do të ndërtojë 8 godina si investitor në projektin Univers City nga Balfin Group.



KOMPLEKSI REZIDENCIAL TIRANA UPTOWN

Vendndodhja: : Rruga "5 Maji", Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2021 – 2026

Sipërfaqja e ndërtimit: 77,963 m²

Klienti: Progeen shpk (investim i shoqërisë)

Detyra: Ndërtimi i një kompleksi rezidencial që përfshin apartamente, njësi tregtare, parkim nëntokësor dhe gjelbërim e sheshe

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim, me çelësa në dorë

Kompleksi "Tirana Uptown" është kompleksi i ri më i afërt me qendrën e Tiranës me vetëm 1.6 km distancë prej saj.

Ky projekt është i ndarë në tre faza, ku secila fazë është një mini-kompleks më vete i përbërë nga apartamente banimi, ambiente tregtare, parkim nëntokësor, hapësira rekreative, sheshe dhe gjelbërim. Në total do ndërtohen 10 godina multi-funksionale në një sipërfaqe totale ndërtimi prej 77,963 m².

Kompleksi ka një arkitekturë bashkëkohore dhe teknologji ndërtimi të standarteve të larta, si fasadë e ventiluar, dritare termike, izolim akustik, ventilime individuale, instalime për panele diellore etj.

Gjithashtu, e integruar në kompleks ndodhet një fashë e gjelbëruar e cila lidhet me "Pyllin Orbital" të Tiranës, i cili ndodhet vetëm 300 metra në veri të kompleksit.

Kohëzgjatja e kontratës


2021 – 2026

Sipërfaqe ndërtimi

77,963 m²

Tipi i Kontratës

**Investim
Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



NDËRTIMI I GODINËS SË PARKIMIT, DURRËS

Vendndodhja: Stacioni i Trenit, Durrës | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2024

Sipërfaqja e ndërtimit: 16,925 m²

Klienti: Qeveria e Republikës së Shqipërisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Detyra: Ndërtimi i godinës së parkimit me 6 nivele

Tipi i kontratës: Ndërtim

Godina e parkimit me 6 nivele po ndërtohet pranë Stacionit të Trenit në Durrës. Një vepër tepër e rëndësishme publike në dispozicion për 450 mjete dhe evente të ndryshme në një hapësirë të posaçme në nivelin e sipërm. Objekti pritet të mbarojë në harkun kohor të një viti dhe do të furnizohet me energji diellore.

Ky projekt financohet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Kohëzgjatja e kontratës

2024

Sipërfaqja ndërtimi

16,925 m²

Tipi i Kontratës

Ndërtim



BANESA TË RINDËRTIMIT SPITALLË: LOTET 1D DHE 2C

Vendndodhja: : Spitalë, Durrës | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2022 – 2023

Sipërfaqja e ndërtimit: 33,120 m²

Klienti: Eagle Hills Enterprise Properties – Sole Proprietorship LLC financuar nga Projektet e Fondit për Zhvillim të Abu Dabit në Republikën e Shqipërisë

Detyra: Ndërtimi me çelësa në dorë i 25 godinave 3 dhe 4 katëshe.

Tipi i kontratës: Ndërtim me çelësa në dorë (FIDIC RED BOOK)

Ndërtimi me çelësa në dorë i lotëve 1D dhe 2C të projektit të banesave të rindërtimit në zonën e Spitalës konsistoi në ndërtimin e 25 godinave 3-4 katëshe dhe infrastrukturën e nevojshme për apartamente banimi.

Godinat do të strehojnë familjet e prekura nga tërmeti i Nëntorit 2019 dhe do t'u ofrojnë banorëve të gjithë facilitetet e nevojshme për një jetesë komode.

Ky projekt u financua nga Fondi i Abu Dabit për Republikën e Shqipërisë, ndërsa kontrata u menaxhua nga Eagle Hills Enterprise Properties – Sole Proprietorship LLC.

Kohëzgjatja e kontratës

2022 – 2023

Sipërfaqe ndërtimi

33,120 m²

Tipi i Kontratës

**Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



REZIDENCË BANIMI PRANË STADIUMIT "SELMAN STERMASI"

Vendndodhja: Rruga "Hiqmet Delvina", Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2022 – 2024

Sipërfaqja e ndërtimit: 8,804 m²

Klienti: GJ&E shpk, Evisa Construction shpk, Derveni shpk, Geared shpk

Detyra: Ndërtimi me çelësa në dorë i një godine 11 katëshe me 2 kate parkim nëntokësor dhe ambiente tregtare në katin 0

Tipi i kontratës: Ndërtim me çelësa në dorë

Një godinë rezidenciale e pozicionuar në një nga zonat më të kërkuara të Tiranës, Pranë kryqëzimit të Rrugës "Sulejman Delvina" dhe Rrugës "Komuna e Parisit".

Pozicioni i godinës ofron akses të lehtë në zonat më të frekuentuara të Tiranës. Godina 11 katëshe po ndërtohet me teknologjinë më moderne të ndërtimit dhe përfshin elementë si fasada e ventiluar, sistem izolimi akustik, strukturë me soleta monolite të lehtësuara nëpërmjet teknologjisë U-Boot etj.

Godina pritet të përfundojë në fund të vitit 2024.

Kohëzgjatja e kontratës


2022 – 2024

Sipërfaqja ndërtimi

8,804 m²

Tipi i Kontratës

**Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



HARTIM I PROJEKTIT DHE ZBATIMI I PUNIMEVE PËR NDËRTIMIN E GODINËS 6 (SEKSIONI A)

Vendndodhja: Kombinat, Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: Janar – Shtator 2021

Sipërfaqja e ndërtimit: 12,655 m²

Klienti: Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Detyra: Ndërtimi me çelësa në dorë i seksionit A të godinës 6 dhe 8-katëshe

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim me çelësa në dorë

Kjo godinë është pjesë e një kompleksi rezidencial, e cila u ndërtua për familjet që humbën shtëpitë e tyre prej tërmetit të vitit 2019.

Godina u ndërtua me teknologjinë më bashkëkohore të ndërtimit, në mënyrë që të ofrojnë kushte sa më të mira jetese për banorët e ardhshëm.

Objekti u ndërtua me sistem termoizolimi kapotë, izolim akustik ndërmjet apartamenteve dhe parkim nëntokësor.

Kohëzgjatja e kontratës

2021

Sipërfaqe ndërtimi

12,655 m²

Tipi i Kontratës

**Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



REZIDENCA IRIS 2021–2023

Vendndodhja: Rruga "Zihni Sako", pranë "Oxhakut", Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2021 – 2023

Sipërfaqja e ndërtimit: 7,974 m²

Klienti: Progeen shpk, Enos shpk

Detyra: Projektim & ndërtim të dy godinave rezidenciale me njësi komerciale dhe 2 kate parkim nëntokësor

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim me çelësa në dorë

Dy objektet e reja në ndërtim përbri godinës ekzistuese përbejnë fazën e dytë të ndërtimit të kompleksit Rezidencial IRIS.

Godinat u ndërtuan me të njëjtin standard të lartë ndërtimi karakteristik të Progeen shpk duke përfshirë termo-izolimin tërësor, izolimin akustik maksimal, ventilimet individuale, instalime për panele diellore, lartësi kati 2.87 m etj.

Koncepti "IRIS" ka për qëllim krijimin e një kompleksi rezidencial modern dhe komod për banorët e tij..

Kohëzgjatja e kontratës

2021 – 2023

Sipërfaqja ndërtimi

7,974 m²

Tipi i Kontratës

**Investim
Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



NDËRTIMI I GODINËS SË PARKIMIT DHE HAPËSIRAVE MBËSHTETËSE NË GJIROKASTËR

Vendndodhja: Sheshi "Çerçiz Topulli", Gjirokastrë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2021-2022

Sipërfaqja e ndërtimit: 10,000 m²

Klienti: Qeveria e Republikës së Shqipërisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Detyra: Ndërtimi i 3 kateve parkimi nëntokësor

Tipi i kontratës: Ndërtim

Godina me 3 kate parkim nëntokësor, me një kapacitet të përgjithshëm prej 300 posteve parkimi, u ndërtua në qendrën historike të qytetit të Gjirokastrës. Ky projekt do të ketë një ndikim të konsiderueshëm në vijimin e zhvillimit turistik të qytetit. Pjesa kryesore e sheshit (mbi parkimin) do të kthehet në zonë pedonale. Duke qenë se parkimi ndodhet në skarpate, dy kate të tij janë të dukshme nga njëra anë e parkimit me elementë dekorativë.

Kohëzgjatja e kontratës

2021 – 2022

Sipërfaqja ndërtimi

10,000 m²

Tipi i Kontratës

Ndërtim



Kohëzgjatja e kontratës

2021 – 2022

Sipërfaqe ndërtimi

8,597 m²

Tipi i Kontratës

**Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**

RINDËRTIMI I NJËSIVE TË BANIMIT PËR ZONËN E RE PËR ZHVILLIM VALIAS, BLOKU 2, OBJEKTET 1, 2, 3, 4, 5 DHE 6

Vendndodhja: Valias, Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2021 – 2022

Sipërfaqe e ndërtimit: 8,597 m²

Klienti: Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Detyra: Ndërtimi me çelësa në dorë i njësive të banimit për zonën e re për zhvillim Valias, Blloku 2, Objektet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim me çelësa në dorë

Ky projekt ndërtimi u porositi në kuadër të rindërtimit të banesave për familjet e prekura nga tërmeti i vitit 2019.

Këto 6 godina banimi 4-katëshe me ambientet e parkimit dhe sistemimet e gjelbërimit përreth u ndërtuan për një afat shumë të kufizuar kohor në mënyrë që t'u viheshin në shërbim familjeve të cilat humbën shtëpitë e tyre prej tërmetit.

Godinat u ndërtuan me sistem termoizolimi kapotë, izolim akustik ndërmjet apartamenteve, hapësira të gjelbra përreth dhe parkim nëntokësor.



RINDËRTIMI I NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA PËR ZONA E RE PËR ZHVILLIM

Vendndodhja: Njësia administrative Lezhë 1, Lezhë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: Prill 2021 – Tetor 2021

Sipërfaqja e ndërtimit: 12,130 m²

Klienti: Qeveria e Republikës së Shqipërisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Detyra: Projektimi dhe ndërtimi i një godine rezidenciale me njësi tregtare dhe parkim nëntokësor

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim me çelësa në dorë

Këto godina u ndërtuan në kuadër të rindërtimit pas tërmetit të Nëntorit 2019 nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Godinat u ndërtuan me teknologji moderne ndërtimi. Ato kanë hapësira të gjelbëruara, parkim nëntokësor dhe njësi tregtare në katin përdhe.

Sfida me këtë projekt ishte koha e shkurtër në dispozicion. I gjithë aktiviteti i ndërtimit përfundoi në 9 muaj.

Kohëzgjatja e kontratës

2021

Sipërfaqe ndërtimi

12,130 m²

Tipi i Kontratës

**Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE, PALESTRËS DHE KOPSHTIT "SHERIF DERVISHI"

Vendndodhja: Budull, Krujë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: Janar – Shtator 2021

Sipërfaqja e ndërtimit: 1,416 m²

Klienti: UNDP me financim të BE

Detyra: Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare, palestrës dhe kopshtit

Tipi i kontratës: Ndërtim me çelësa në dorë

Shkolla 9-vjeçare "Sherif Dervishi" në Budull, pjesë e njësisë administrative Bubq të Bashkisë së Krujës, u rindërtua me ndihmën e një donacioni të Bashkimit Evropian, përmes UNDP (programi EU4SCHOOLS). Ky projekt u hartua nga D&C Partners dhe u ndërtua nga shoqëria Progeen shpk.

Ndërtesa është ngritur në një terren të ri ndërtimi dhe ka në dispozicion ambiente moderne mësimdhënie, një palestër, dhe terrene sportive të hapura. Godina ka 2 kate dhe një sipërfaqe totale ndërtimi prej 1,416 m².

Kohëzgjatja e kontratës

2021

Sipërfaqja ndërtimi

1,416 m²

Tipi i Kontratës

**Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



XHAMIA PERSIANE NË ASHRAF 3

Vendndodhja: Ashraf 3, Manëz, Durrës | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: Dhjetor 2021-Prill 2022

Sipërfaqja e ndërtimit: 250 m² + 400 m²

Klienti: International Liberty Association

Detyra: Ndërtim me çelësa në dorë i një objekti kulti

Tipi i kontratës: Ndërtim me çelësa në dorë

Ky objekt kulti është investim i huaj që shërben si shtëpi besimi për qytetarët Iranianë të mërguar të cilët jetojnë në Ashraf 3, zonë e ndërtuar enkas për banim për këta qytetarë.

U zhvilluan punimet e seksionit hyrës të xhamisë bashkë me dy minaret në anët e portës hyrëse. Gjithashtu u ndërtua edhe struktura metalike mbajtëse e çatisë dhe kupola e ndërtuar me strukturë metalike dhe xham të tejdukshëm.

Kohëzgjatja e kontratës

2021 – 2022

Sipërfaqja ndërtimi Sistemim & Sheshe

250 m² 400 m²

Tipi i Kontratës

**Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



Kohëzgjatja e kontratës

2017 – 2020

Sipërfaqe ndërtimi

11,718 m²

Tipi i Kontratës

**Investim
Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**

REZIDENCA RAINBOW

Vendndodhja: Rruga "Albanopoli", Lagjia "Don Bosko", Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2017 – 2020

Sipërfaqe e ndërtimit: 11,718 m²

Klienti: Progeen shpk (Investim i shoqërisë)

Detyra: Projektimi dhe ndërtimi i një godine 9-katëshe me një kat ambiente tregtare dhe 1 kat parkim nëntokësor, hapësira të gjelbërta dhe sheshe

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim me çelësa në dorë

Rezidenca "Rainbow" është një objekt me dy seksione, me një stil shumë të veçantë arkitekturor, e pozicionuar në zonën e "Don Boskos". Godina ka një harmoni dhe kombinim ngjyrash, si dhe është projektuar sipas standardeve evropiane. Rëndësi e veçantë i është dhënë izolimit akustik dhe termik.

Rezidenca "Rainbow" ka hapësira të mirë-organizuar rekreative dhe teknike me gjelbërim të mjaftueshëm dhe sheshe. Tarraca e godinës ka hapësira rekreative si dhe vende për panele diellore për çdo apartament.



REZIDENCA IRIS 2018–2021

Vendndodhja: Rruga "Zihni Sako", pranë "Oxhakut", Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2018 – 2021

Sipërfaqja e ndërtimit: 6,965 m²

Klienti: Progeen shpk, Enos shpk

Detyra: Ndërtimi i një godine banimi 7-katëshe me 1 kat njësi tregtare dhe 2 kate parkim nëntokësor

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim me çelësa në dorë

Rezidenca Iris është godina e parë, pjesë përbërëse e një blloku banimi me tre godina të ngjashme në arkitekturë dhe funksionalitet. Ky bllok është konceptuar si një bllok modern me godina 7 dhe 8 katëshe ku funksioni kryesor është banimi, por duke lënë edhe hapësira të nevojshme për shërbime, zyra dyqane dhe një kat hotelerie, si dhe dy kate parkimi nëntokësor.

Godina ndodhet në zonën e "Oxhakut", pranë kryqëzimit të Rrugës "Zihni Sako" me Rrugën "Xhanfize Keko", vetëm 2.4 km nga qendra e Tiranës.

Kohëzgjatja e kontratës

2018 – 2021

Sipërfaqja ndërtimi

6,965 m²

Tipi i Kontratës

**Investim
Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



11 GODINA REZIDENCIALE DHE SHËRBIMI, HOTEL & MONUMENTE NË ASHRAF 3

Vendndodhja: Manëz, Durrës | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: Shtator – Nëntor 2016, Maj-Korrik 2019

Sipërfaqja e ndërtimit: 23,400 m²

Klienti: FARA Association, All For Freedom Ltd

Detyra: Ndërtim i 11 godinave rezidenciale dhe shërbimi, hotel & monumente

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim me çelësa në dorë

Progeen shpk ndërtoi 11 ndërtesa për anëtarët e Opozitës Iraniane në Mërgim, të cilët jetojnë në Shqipëri. Ndërtesat ofrojnë një hapësirë të rehatshme për jetesë dhe punë. Këto ndërtesa janë pjesë e projektit Ashraf 3, një qytet i vogël Iranian në Shqipëri, i cili tashmë ka të gjithë facilitetet e nevojshme për një jetesë optimale. 11 Godinat e para 2 katëshe u ndërtuan në vetëm 4 muaj.

Gjithashtu, në një afat 3 mujor, u ndërtuan disa monumente që përkujtojnë martirët e rënë gjatë lëvizjes opozitare të Iranit kundër regjimit Islamik. Elementët vertikalë të realizuar me gurë mermeri që qëndrojnë në struktura metalike përmbajnë yje, të cilët simbolizojnë jetët e sakrifikuara për lirinë e Iranit. Harku qendror, i cili ndodhet në fund të shkallëve të gurit, është një vend meditimi e përkujtim i sakrificës së tyre.

Përveç këtij monumenti, në hyrje të kampit është ndërtuar edhe një hark me dy luanë mbi të, i cili simbolizon të ardhmen e këtij vendi pas fitores së lirisë. Gjithashtu, u ndërtua një njësi akomoduese e cila priti personalitete të famshme të politikës botërore.

Kohëzgjatja e kontratës

2016 – 2019

Sipërfaqja ndërtimi

23,400 m²

Tipi i Kontratës

**Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



REZIDENCA PROGEEN II

Vendndodhja: Rruga "Bardhyl", Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2015 – 2017

Sipërfaqja e ndërtimit: 5,747 m²

Klienti: Progeen shpk (investim i shoqërisë)

Detyra: Projektimi dhe ndërtimi i një godine banimi 6-katëshe me 2 kate ambiente tregtare dhe 2 kate parkim nëntokësor

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim me çelësa në dorë

Rezidenca Progeen II është ndërtuar me një fasadë unike ku ndërthuret fasada e ventiluar me mermer me sistemin kapotë të veshur me tullë dekorative terakota. Ajo është pozicionuar në një nga arteriet kryesore të Tiranës.

Godina dallon për materialet e ndërtimit tejet cilësore dhe për stilin arkitekturor. Hapësirat rekreacionale të mirë menduara dhe aksesit nga rruga kryesore (unaza e vogël e Tiranës) e bëjnë këtë godinë një investim që do t'i rezistojë kohës. Godina ka 4 kate banimi, 2 kate hapësira tregtare dhe 2 kate parkim nëntokësor.

Kohëzgjatja e kontratës

2015 – 2017

Sipërfaqja ndërtimi

5,747 m²

Tipi i Kontratës

**Investim
Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



REZIDENCA PROGEEN I

Vendndodhja: Rruga "Zihni Sako", Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2015 – 2017

Sipërfaqja e ndërtimit: 7,741 m²

Klienti: Progeen shpk (investim i shoqërisë)

Detyra: Projektimi dhe ndërtimi i një godine 8 katëshe me një kat ambiente tregtare dhe 2 kate parkim nëntokësor

Tipi i kontratës: Projektim, Ndërtim me çelësa në dorë

Progeen I ishte guri i themelit i ndërtimeve rezidenciale të shoqërisë Progeen, pasi është godina e parë rezidenciale e ndërtuar nga shoqëria.

Objekti është i pozicionuar në zonën e Oxhakut dhe ka akses tepër të mirë në arteriet kryesore të Tiranës. Punimi i fasadës me sistem kapotë, cilësia dhe inovacioni i ndërtimit, si dhe përzgjedhja e ngjyrave, e bëjnë të spikasë ne zonë

Kohëzgjatja e kontratës

2015 – 2017

Sipërfaqja ndërtimi

7,741 m²

Tipi i Kontratës

**Investim
Projektim,
Ndërtim me
Çelësa në Dorë**



Kohëzgjatja e kontratës

2021

Tipi i Kontratës

Ndërtim

NDËRTIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I GODINËS SË ALEATIT

Vendndodhja: Rruga "Xhanfize Keko", Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2016 – 2017

Sipërfaqja e ndërtimit: 1,800 m²

Klienti: Investitor Privat

Detyra: Projektim & Ndërtim me çelësa në dorë i godinës së re si dhe rikonstruksion I godinës ekzistuese

NDËRTIMI I SHKOLLËS SË PËRKOHSHME 9-VJEÇARE "VAT BUSHI"

Vendndodhja: Lalëz, Durrës | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2021 (45 ditë)

Klienti: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, financuar nga KfW

Detyra: Ndërtimi i një shkolle prej kontejnerëve metalikë me panele sandwich të parafabrikuar

Tipi i kontratës: Ndërtim



Sipërfaqja e ndërtimit **1,800 m²**

Tipi i Kontratës
Projektim & Ndërtim



Kohëzgjatja e kontratës

2015 – 2016

Tipi i Kontratës

Nënkontraktim

MAGAZINË MULTI-FUNKSIONALE

Vendndodhja: Zonë Industriale, Tiranë | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2015 – 2016

Sipërfaqja e ndërtimit: 1,100 m²

Klienti: Investitor Privat

Detyra: Projektim & ndërtim i një magazine industriale me konstrukcion metalik dhe panele sandwich

Tipi i kontratës: Projektim & Ndërtim me çelësa në dorë

RAPUN HEC

Vendndodhja: Rapun, Elbasan | Shqipëri

Kohëzgjatja e kontratës: 2015 – 2016

Klienti: HEC Rapun

Detyra: Instalimi i turbinave Francis, spirale horizontale si edhe zyrës operative


Tipi i kontratës: Ndërtim, Montim (Nënkontraktor)



Sipërfaqja e ndërtimit **1,100 m²**

Tipi i Kontratës
Projektim & Ndërtim







ÇERTIFIKIMET

Progeen shpk është e përkushtuar të punojë në përputhje me standardet më të larta të ndërtimit në vend.

Shoqëria ka marre certifikime të rëndësishme që vërtetojnë zbatimin e standardeve të larta në menaxhimin e të gjitha fazave të projekteve ndërtimore.



ADRESA:

Rruga "Shyqyri Bërxolli"
Pallati "Intercosat"
Shkalla A, Kati I
Tiranë, Shqipëri

KONTAKT:

Tel: +355 69 241 6615
Email: info@progeen.com
Web: www.progeen.com